



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06/IA009

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 17 gusht 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës së Apelit për shqyrtimin e
kërkesave në lidhje me numrin e lejuar të fjalëve**

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatëse Nina Jorgensen

Mbrojtësit të Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit:

Ben Emerson

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtësit të viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagenda

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)-(3) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullave 13(1)(c), 97(3), 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve (“Kërkesa e Parë”)¹ dhe Kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit, Selimit dhe Thaçit për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve (“Kërkesa e Dytë”)² për apelimin e Vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara (“Vendimi mbi Juridiksionin”).³

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin mbi Juridiksionin, në të cilin miratoi pjesërisht disa aspekte të kundërshtimeve të ngritura, dhe rrëzoi pjesën tjetër të kundërshtimeve të ngritura nga të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore.⁴

2. Më 27 korrik 2021, Kryetarja caktoi një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur për kërkesat lidhur me afatet për apelimin e Vendimit mbi Juridiksionin.⁵

¹ IA009/F00006, Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 16 gusht 2021.

² IA009/F00007, Kërkesë e Mbrojtjes së Krasniqit, Selimit dhe Thaçit për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 16 gusht 2021.

³ F00412, Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 22 korrik 2021.

⁴ Shih Vendimin mbi Juridiksionin, para. 214.

⁵ KSC-BC-2020-06/IA009/F00004, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit për Shqyrtimin e Kërkesave lidhur me Afatet, 27 korrik 2021.

3. Më 16 gusht 2021 z. Veseli dorëzoi Kërkesën e Parë⁶ dhe në të njëjtën ditë zotërinjtë Krasniqi, Selimi dhe Thaçi dorëzuan Kërkesën e Dytë.⁷

II. DISKUTIM

4. Në Kërkesat që kanë të bëjnë me ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve për apelet kundër Vendimit mbi Juridiksionin, Mbrojtja e z. Veseli, z. Krasniqi, z. Selimi dhe z. Thaçi kërkon - në përputhje me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Udhëzuesi i Punës") - shtimin e numrit të lejuar të fjalëve për apelet deri në 13000 fjalë.⁸

5. Mbrojtja e Veselit kërkon që vetë Kryetarja të miratojë masën ndreqëse që kërkohet.⁹ Megjithatë, dhe sikurse theksohet në një vendim të mëparshëm, sipas nenit 33(1)-3 të Ligjit dhe rregullës 13(1)(c) të Rregullores, funksioni kryesor administrativ i Kryetares është të caktojë gjykatësit në panele gjyqësore për të shqyrtuar parashtrimet e palëve dhe për të nxjerrë vendimet përkatëse.¹⁰ Për më tepër, dhe sikurse përcaktohet në nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës, kompetenca e marrjes së vendimit mbi një kërkesë për shtimin e numrit të lejuar të fjalëve në këtë rast konkret duhet t'i lihet një paneli të caktuar.¹¹

6. Rregulla 169 e Rregullores parashikon se "[n]ë bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit, Kryetari cakton një panel të Gjykatës së Apelit pas paraqitjes së kërkesës për apel të ndërmjetëm të dorëzuar në bazë të së drejtës së vetvetishme, [...] ose sikurse mund ta

⁶ IA009/F00006, Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 16 gusht 2021.

⁷ IA009/F00007, Kërkesë e Mbrojtjes së Krasniqit, Selimit dhe Thaçit për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 16 gusht 2021

⁸ Kërkesa e Parë, para. 9; Kërkesa e Dytë, para. 13

⁹ Kërkesa e Parë, para. 9.

¹⁰ KSC-BC-2020-06/IA009/F00004, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit për Shqyrtimin e Kërkesave lidhur me Afatet, 27 korrik 2021, para. 8 *et seq.*

¹¹ KSC-BC-2020-06/IA009/F00004, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit për Shqyrtimin e Kërkesave lidhur me Afatet, 27 korrik 2021, para. 9.

lypë nevoja" (theksimi i shtuar).¹²

7. Duke pasur parasysh rëndësinë e marrjes së vendimit mbi Kërkesën *sub judice* para përfundimit të afatit për dorëzimin e apelit, i cili ende nuk është dorëzuar, Kryetarja e gjykon të nevojshme të caktojë një panel të Gjykatës së Apelit, në përputhje me formulimin në fund të rregullës 169 të Rregullores.

III. CAKTIMI

8. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Emilio Gati

Gjykatësen Nina Jorgensen

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me Kërkesën e Parë dhe Kërkesën e Dytë.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E martë, 17 gusht 2021
Në Hagë,
Holandë

¹² Shih edhe KSC-BC-2020-06/IA009/F00004, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit për Shqyrtimin e Kërkesave lidhur me Afatet, 27 korrik 2021, para. 10.